



VLERËSIMI I NDIKIMIT TË GARAVE TË VERËS TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

GARATE VERËS 2024



Përmbajtja

Lista e figurave	2
Lista e tabelave	2
Përmbledhja ekzekutive	3
Të gjeturat kryesore.....	3
Metodologjia e hulumtimit.....	4
Angazhimi në rrjete sociale	5
Impakti organizativ	7
Profili demografik i shikuesve	8
Impakti social i shikuesve	10
Impakti ekonomik	16
Impakti ekonomik direkt	16
Impakti ekonomik indirekt	17
Impakti Sportiv.....	18
Përfundime.....	21

Lista e figurave

Figura 1. Mediat me numrin më të madh të artikujve të publikuar (n=numri i artikujve të publikuar) ...	5
Figura 2. Mediat me numrin më të madh të angazhimeve (pëlqime, shpërndarje, komente) (n=numri i angazhimeve).....	6
Figura 3. Lajmi/ngjarja me numrin më të madh të angazhimeve (pëlqime, shpërndarje, komente)	6
Figura 4. Vendndodhja e ndeshjeve	8
Figura 5. Shpërndarja e shikuesve total sipas garës	9
Figura 6. Shpërndarja e shikuesve sipas moshës	10
Figura 7. A është hera e parë që merrni pjesë në një aktivitet të organizuar nga FBK-ja?	10
Figura 8. Sa shpesh merrni pjesë në aktivitete sportive të organizuara nga FBK-ja?	11
Figura 9. Sa shpesh merrni pjesë në aktivitete sportive të organizuara nga FBK-ja? *Sipas gjinisë.....	11
Figura 10. A jeni ju apo ndonjëri nga grupi juaj aktiv në sport?.....	12
Figura 11. A ka rritur ky aktivitet gjasat që ju apo dikush nga grupi juaj të përfshiheni në aktivitete sportive në të ardhmen?.....	12
Figura 12. A ka rritur ky aktivitet gjasat që ju apo dikush nga grupi juaj të përfshiheni në aktivitete sportive në të ardhmen? *Sipas gjinisë.....	13
Figura 13. Si do ta vlerësonit organizimin e këtij aktiviteti në tërësi?	13
Figura 14. A ndiheni krenar për qytetin/shtetin tuaj që organizoi këtë aktivitet?	13
Figura 15. A ndiheni krenar për qytetin/shtetin tuaj që organizoi këtë aktivitet? *Sipas gjinisë.....	14
Figura 16. A mendoni se organizimi i këtij aktiviteti është një arritje për shtetin e Kosovës?.....	14
Figura 17. Si mendoni se ky aktivitet ndikon në perceptimin e Kosovës nga të tjerët?.....	15
Figura 18. A keni vërejtur ndonjë përfitim të komunitetit lokal të Prishtinës nga ky aktivitet?	15
Figura 19. Si ndiheni gjatë pjesëmarrjes në këtë aktivitet?	15
Figura 20. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në disponimin tuaj gjatë pjesëmarrjes në këtë aktivitet? .	16
Figura 21. Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të garave në këtë aktivitet?.....	18
Figura 22. Si e vlerësoni cilësinë e objekteve/sallave ku u zhvilluan aktivitetet?	19
Figura 23. A ka pasur pajisje dhe infrastrukturë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat tuaja? ...	19
Figura 24. Si e vlerësoni organizimin e përgjithshëm të aktivitetit?.....	20
Figura 25. A ishin aktivitetet e organizuara mirë dhe të planifikuara në mënyrë efektive?	20
Figura 26. A keni vërejtur përmirësime në performancën e ekipit tuaj si rezultat i pjesëmarrjes në këtë aktivitet?	21

Lista e tabelave

Tabela 1. Përmbledhje e angazhimit në rrjete sociale	5
Tabela 2. Shpërndarja e shikuesve sipas gjinisë.....	9
Tabela 3. Përmbledhje e impaktit ekonomik indirekt	17

Përmbledhja ekzekutive

Ky raport paraqet vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve verore të basketbollit të organizuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), duke përdorur një qasje të kombinuar të hulumtimit sasior dhe cilësor, si dhe të dhënave primare nëpërmjet anketave dhe dytësore si analizimi i angazhimit në rrjete sociale. Vlerësimi analizon ndikimin sportiv, ekonomik, social dhe atë të zhvillimit organizativ që këto ngjarje kanë sjellë. Aktivitetet e vlerësuara përfshijnë garat: *FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier* (35 ndeshje të zhvilluara), *FIBA Small Countries* (20 ndeshje të zhvilluara), *FIBA 3x3 Challenger* (25 ndeshje të zhvilluara), *FIBA 3x3 Women's Series* (17 ndeshje të zhvilluara) dhe *FIBA U18 Women's Eurobasket* (15 ndeshje të zhvilluara). Objektivi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi përfitimet e këtyre aktiviteteve, duke u shërbyer si bazë për planifikimin strategjik të FBK-së dhe komunitetit të basketbollit në Kosovë për të ardhmen. Rezultatet dhe përfundimet që dalin nga ky raport synojnë të ndihmojnë në forcimin e pozicionit të FBK-së si një organizator lider në rajon dhe në maksimizimin e impaktit pozitiv për komunitetin e saj dhe palët e interesit.

Të gjeturat kryesore

Angazhimi në rrjete sociale

- Gjatë periudhës së monitorimit, Instagrami shënoi angazhimin më të lartë me 26,579 ndërveprime nga 137 postime, pasuar nga Facebook me 12,549 angazhime nga 473 postime.
- Shpallja e Kosovës kampione në FIBA U18 Women's EuroBasket, Divizioni C, më 28 korrik 2024, shënoi kulmin e angazhimit me një numër të madh reagimesh dhe ndërveprimesh, duke arritur një pikë kulminante të angazhimit ditor, përmes 33 artikujsh dhe postimesh.

Impakti organizativ

- Të intervistuarit theksuan përmirësimet e dukshme në kapacitetin organizativ të FBK-së, duke përfshirë rritjen e përvojës së stafit dhe vullnetarëve. Gjatë viteve, organizimi është bërë më efikas, pavarësisht disa sfidave me infrastrukturën, dhe aktivitetet kanë kontribuar në zhvillimin e aftësive organizative, punën në ekip dhe rrjetëzimin për të gjithë të përfshirët.
- Ka pasur një përmirësim të ndjeshëm në marrëdhëniet me sponsorët dhe autoritetet, përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe komunat, duke çuar në mbështetje të vazhdueshme dhe një rritje të pjesëmarrjes dhe interesit të sponsorëve. Bashkëpunimi me palët e interesit ka qenë gjithashtu shumë më i mirë këtë vit, duke ndihmuar në realizimin efektiv të aktiviteteve.

Profili demografik i shikuesve

- Nga 8,654 shikues në total përgjatë 112 ndeshjeve të zhvilluara, 45% janë femra (3,885 shikues) dhe 55% janë meshkuj (4,769 shikues). Shikuesit më të shumtë janë ata midis 18-34 vjeç, të cilët përbëjnë 45% të totalit të shikuesve.
- FIBA 3x3 Challenger ka tërhequr pjesëmarrësit më të shumtë, me 38% të audiencës. Po ashtu, Sheshi Zahir Pajaziti është vendi më i frekuentuar, me 41% të totalit të shikuesve, ndërsa Salla 1 Tetori ka pasur audiencën më të ulët, me 13%.

Impakti social i shikuesve

- 55% e shikuesve kanë marrë pjesë më parë në aktivitete të organizuara nga FBK, duke treguar angazhim të vazhdueshëm. 45% e të anketuarve kanë marrë pjesë për herë të parë, duke sugjeruar se ngjarjet tërheqin gjithashtu një numër të konsiderueshëm të shikuesve të rinj.
- Femrat kanë një prirje disi më të lartë për t'u angazhuar rregullisht në aktivitete sportive të organizuara nga FBK-ja, me 78% që marrin pjesë shpesh ose shumë shpesh, në krahasim me 70% të meshkujve.
- 52% e pjesëmarrësve janë të motivuar për t'u angazhuar në aktivitete sportive në të ardhmen, me një ndikim më të madh të shprehur nga femrat, ku 56% raportojnë se aktiviteti i ka rritur gjasat për t'u angazhuar në sport.

Impakti ekonomik

- Shpenzimet totale direkte të llogaritura për organizimin e ngjarjeve sportive të verës nga FBK janë € 269,129.80 euro, ndërsa ato indirekt të llogaritura përmes shpenzimeve të ekipeve, arritën një total prej 150,741.26 euro
- Shpenzimet totale direkte dhe indirekt, apo kontributi total në ekonominë e Kosovës për këtë turne arritën në 419,871.06 euro.

Impakti sportiv

- Shumica e pjesëmarrësve në gara (73%) e vlerësuan cilësinë e garave si të lartë ose shumë të lartë, duke treguar një perceptim pozitiv mbi organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive.
- 55% e pjesëmarrësve e vlerësuan cilësinë e objekteve si mesatare, ndërsa një pjesë e konsiderueshme (23%) e vlerësuan si të lartë, duke sugjeruar se ka ende mundësi për përmirësime në infrastrukturën sportive.
- 77% e pjesëmarrësve raportuan se infrastruktura dhe pajisjet ishin të mjaftueshme për nevojat e tyre, por 23% sugjeruan nevojën për përmirësime në këtë aspekt.
- 63% e pjesëmarrësve e vlerësuan organizimin e aktivitetit si të lartë ose shumë të lartë, duke treguar një kënaqësi të madhe mbi planifikimin dhe menaxhimin e aktivitetit.
- 59% e pjesëmarrësve raportuan përmirësime në performancën e ekipeve të tyre si rezultat i pjesëmarrjes në aktivitet, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit dhe kohezionit brenda skuadrës.

Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e këtij studimi përfshiu mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare për të siguruar një analizë të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Të dhënat primare u grumbulluan përmes anketave dhe intervistave të realizuara me ekipet pjesëmarrëse, shikuesit, organizatorët dhe vullnetarët, duke ofruar informacion të dorës së parë mbi përvojat dhe shpenzimet e tyre. Ndërkohë, të dhënat sekondare përfshinë analizën e të dhënave ekzistuese organizative dhe vlerësimin e performancës në rrjetet sociale.

Për të vlerësuar impaktin ekonomik të turneut, u realizuan 41 intervista me përfaqësues të ekipeve pas përfundimit të aktivitetit. Njëkohësisht, një formular i posaçëm u përdor për të regjistruar shikuesit gjatë ndeshjeve, duke mundësuar krijimin e profilit demografik të tyre. Për vlerësimin e impaktit

sportiv, u kryen 44 anketa me përfaqësues të ekipeve, ndërsa për vlerësimin e impaktit social u zhvilluan 265 anketa me shikuesit e ndeshjeve. Për të vlerësuar zhvillimin organizativ, u realizuan tre intervista të thelluara me përfaqësues të Federatës së Basketbollit të Kosovës. Kjo qasje metodologjike siguroi një analizë gjithëpërfshirëse të aspekteve ekonomike, sportive, sociale dhe organizative të turneut.

Angazhimi në rrjete sociale

Gjatë periudhës së monitorimit nga 15 qershori deri më 15 shtator 2024, 25 media publikuan gjithsej 107 artikuj lajmesh që mbulonin ngjarjet e FIBA U18 dhe 3x3 në Prishtinë. Në Facebook, këto ngjarje u pasqyruan në 473 postime, duke gjeneruar 12,549 angazhime. Instagrami shënoi një shkallë më të lartë angazhimi me 137 postime, duke grumbulluar 26,579 ndërveprime. Në YouTube, u ngarkuan 11 video që morën 1,242 shikime, ndërsa në TikTok u postuan 13 video që gjeneruan 3,792 angazhime. LinkedIn kontribuoi me 9 postime, të cilat rezultuan në 41 angazhime.

Tabela 1. Përmbledhje e angazhimit në rrjete sociale

Burimi	Angazhime	Postime	Pëlqime	Shpërndarje	Komente	Shikueshmëria	Audienca e arritur
Media	920	107	512	376	32	N/A	599,000
Facebook	12,549	473	11,461	512	576	N/A	843,000
Instagram	26,579	137	26,479	0	100	N/A	453,000
YouTube	10	11	0	0	0	1,242	N/A
TikTok	3,792	13	3,785	0	7	N/A	N/A
LinkedIn	41	9	36	4	1	N/A	N/A

Gjatë periudhës së monitorimit të mediave dixhitale për FIBA U18 & 3x3, *Bota Sot* luajti një rol kyç në mbulimin e aktiviteteve, duke publikuar 32 artikuj, një numër dukshëm më i lartë krahasuar me mediat e tjera. *RTK* u rendit e dyta me 11 artikuj të publikuar, e ndjekur nga *Gazeta Olle* me 10 artikuj. Ndërkohë, *Arbresh* dhe *Zëri* kishin një prani më të kufizuar, me përkatësisht 8 dhe 7 artikuj.




Figura 1. Mediat me numrin më të madh të artikujve të publikuar (n=numri i artikujve të publikuar)

Për më tepër, të dhënat nga monitorimi i mediave dixhitale për FIBA U18 & 3x3 tregojnë se *RTK* jo vetëm që ishte media me angazhimin më të madh në rrjetet sociale (259 angazhime), por gjithashtu pati një numër relativisht të lartë artikujsh të publikuar (11). Në kontrast, *Bota Sot*, edhe pse publikoi më shumë artikuj (32), pati një angazhim më të ulët, duke grumbulluar 189 angazhime. *Gazeta Olle*, me 10 artikuj, pati një performancë të ngjashme në aspektin e angazhimit, duke regjistruar 179 angazhime.

Nga ana tjetër, Klan Kosova dhe Telegrafi publikuan më pak artikuj, përkatësisht 3 dhe 2, dhe gjeneruan një nivel më të ulët angazhimi, me 83 dhe 55 angazhime. Kjo tregon se RTK arriti një balancë më të mirë mes sasisë së artikujve të publikuar dhe aftësisë për të gjeneruar angazhim, duke tejkaluar edhe mediat me më shumë artikuj të publikuar.




Figura 2. Mediat me numrin më të madh të angazhimeve (pëlqime, shpërndarje, komente) (n=numri i angazhimeve)

Shpallja e Kosovës kampione në FIBA U18 Women’s EuroBasket, Divizioni C ishte ngjarja me më shumë angazhim gjatë periudhës së monitorimit, e cila gjeneroi një numër të madh reagimesh dhe ndërveprimesh në mediat dixhitale. E zhvilluar më 28 korrik 2024, kjo datë shënoi gjithashtu pikun ditor të angazhimit, duke tërhequr vëmendjen e madhe të publikut. Ajo u mbulua përmes 33 artikujsh dhe postimesh, duke pasur një impakt të dukshëm në angazhimin e audiencës.



Figura 3. Lajmi/ngjarja me numrin më të madh të angazhimeve (pëlqime, shpërndarje, komente)

Impakti organizativ

Për të vlerësuar zhvillimin organizativ, u analizuan përmirësimet në kapacitetin organizativ, ekspozimin e markës dhe marrëdhëniet me palët e interesit si rezultat i organizimit të këtyre aktiviteteve, përmes intervistimit të zyrtarëve të FBK-së. Për këtë qëllim, u intervistuan 3 zyrtarë të FBK-së, me një përvojë angazhimi me FBK 6-7 vjet.

Përmirësimet në kapacitetin organizativ të FBK-së

Të pyetur nëse kanë vërejtur përmirësime në kapacitetin organizativ të FBK-së si rezultat i organizimit të pesë aktiviteteve verore, të gjithë të intervistuarit u shprehën pozitivisht.

Përmirësimet kryesore që ata shprehen se kanë vënë re lidhen kryesisht me aspektin organizativ. Çdo vit, ata shprehen se kanë bërë përparime, por ende përballen me sfida në menaxhimin financiar të eventeve. Në fillim, për shkak të mungesës së përvojës, u hasën me shumë sfida, por me kalimin e viteve ata u avancuan profesionalisht dhe arritën përmirësime të mëdha në organizim. Përmirësimet më të dukshme ishin te stafi, pasi çdo vit u vërejt rritja e përvojës së tyre. Këtë vit, organizimi ishte më i suksesshëm, pavarësisht disa sfidave me infrastrukturën, dhe stafi bashkë me vullnetarët kontribuan që çdo gjë të zhvillohej më lehtë.

Zhvillimi i aftësive të reja për stafin dhe vullnetarët

Të gjithë të intervistuarit u shprehën pozitivisht se këto aktivitete kanë ndihmuar në zhvillimin e aftësive të reja për stafin e FBK-së. Aftësitë që janë zhvilluar më së shumti përfshijnë **aftësitë organizative, punën në ekip, kontaktet dhe rrjetëzimin**, të cilat janë përmirësuar dukshëm. Përveç stafit, edhe vullnetarët, shumica prej të cilëve janë basketbollistë, kanë përfituar në zhvillimin e aftësive të tyre për të ardhmen. Gjithashtu, përfshirja në seminare dhe workshop-e ka ndihmuar në rritjen e profesionalizmit dhe përvetësimin e aftësive profesionale.

Ndikimi në Perceptimin Publik për FBK-në

Për më tepër, të intervistuarit shprehen se ka patur ndryshim në perceptimin e publikut për FBK-në si rezultat i këtyre aktiviteteve. Në vitet e para, FBK nuk kishte arritur të bënte një impakt të madh me organizimin e eventeve. Megjithatë, organizimi i kampionatit evropian për femra shënoi një përmirësim të dukshëm, me një organizim të shkëlqyer dhe marketing të suksesshëm, duke marrë komente pozitive. Aktualisht, organizimi është përmirësuar më tej, me një fokus të veçantë në numrin e shteteve pjesëmarrëse, gjë që ka ndikuar pozitivisht në perceptimin e shikuesve për basketbollin dhe ka sjellë përfitime për ekonominë e vendit.

Përmirësimi i marrëdhënieve me sponsorët dhe autoritetet

Të intervistuarit pohojnë gjithashtu se ka pasur përmirësime domethënëse në marrëdhëniet me sponsorët, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe komunat, pasi që nga viti 2018 kanë marrë mbështetje të vazhdueshme çdo vit. Veçanërisht gjatë tre viteve të fundit, qeveria ka ofruar mbështetje të plotë, ndërsa Banka TEB është bërë sponsor gjeneral. Marrëdhëniet me autoritetet kanë avancuar, duke rezultuar në një rritje të pjesëmarrjes dhe interesit të sponsorëve. Në vitet e mëparshme, pjesëmarrja ishte më e ulët, pavarësisht ftesave, ndërsa tani ka më shumë sponsorë të interesuar, veçanërisht për formatin 3x3, i cili ofron më shumë mundësi për kontakte me publikun.

Bashkëpunimi me palët e interesit

Bashkëpunimi me palët e interesit gjatë organizimit të aktiviteteve ka qenë shumë më i mirë këtë vit. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shprehen se ka qenë një partner shumë bashkëpunues, ndërsa bashkëpunimi me organet e sigurisë dhe autoritetet shtetërore ka qenë në një nivel të kënaqshëm, madje përtej pritshmërive. Megjithatë, bashkëpunimi me sponsorët ka pasur mangësi, për shkak të mungesës së aktiviteteve nga ana e tyre. Palët e interesit përfshinin Ministrinë e Punëve të Jashtme, komunën e Prishtinës, sponsorët, Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA), dhe federatat tjera kombëtare që morën pjesë. Ky bashkëpunim pohojnë se ishte në një nivel të lartë, ku komunikimi i vazhdueshëm luajti një rol thelbësor që nga fillimi, duke ndihmuar në realizimin efektiv të aktiviteteve.

Profili demografik i shikuesve

Të dhënat e paraqitura në këtë seksion paraqesin profilin demografik të shikuesve gjatë ndeshjeve të Kampionatit Evropian të FIBA-s në vendet e caktuara. Këto të dhëna janë mbledhur nëpërmjet një formulari të posaçëm për të regjistruar shikuesit gjatë ndeshjeve. Sipas të dhënave, Sheshi Zahir Pajaziti ka tërhequr përqindjen më të lartë të shikuesve, me 41%, duke qenë vendi më i frekuentuar. Sheshi Skenderbeu ndjek nga 30% e shikuesve, duke sugjeruar një interes të konsiderueshëm edhe në këtë lokacion. Pallati i Rinisë dhe Sportit ka pasur 17% të shikuesve, ndërsa Salla 1 Tetori ka përqindjen më të ulët të spektatorëve, me 13%. Këto të dhëna tregojnë se sheshet publike kanë tërhequr më shumë spektatorë krahasuar me ambientet e mbyllura.




Figura 4. Vendndodhja e ndeshjeve

Gjatë ndeshjeve të Kampionatit Evropian të FIBA-s, totali i përgjithshëm i pjesëmarrësve ka qenë 8,654, i shpërndarë në 118 ndeshje. Mesatarja e pjesëmarrësve për ndeshje ka qenë rreth 73 shikues, por ka një shpërndarje të lartë siç tregohet nga deviacioni standard prej 65.2. Numri minimal i pjesëmarrësve për një ndeshje ka qenë vetëm 3, ndërsa numri maksimal ka arritur në 260 spektatorë. Kjo tregon se disa ndeshje kanë pasur shumë pak shikues, ndërsa të tjera kanë tërhequr një audiencë më të madhe.

Shpërndarja e shikuesve sipas gjinisë tregon një përfaqësim pak më të lartë të meshkujve në krahasim me femrat. Nga të dhënat, meshkujt përfaqësojnë 55% të totalit të shikuesve, me një numër prej 4,769 pjesëmarrësish. Ndërkohë, femrat përbëjnë 45% të totalit, me 3,885 pjesëmarrëse.

Tabela 2. Shpërndarja e shikuesve sipas gjinisë

Gjinia	Totali	Totali (%)	Mesatarja	Min	Max	Dev std
Meshkuj	4,769	55%	40.42	2	150	35.30
Femra	3,885	45%	32.92	0	150	32.08
TOTALI	8,654		73.34	3	260	65.18

Të dhënat e paraqitura në figurën 5 paraqesin përqindjen e shikuesve të ndarë sipas ngjarjeve të ndryshme sportive të organizuara nga FIBA. FIBA 3x3 Challenger ka tërhequr pjesën më të madhe të shikuesve, duke përfaqësuar 38% të totalit me 3,290 pjesëmarrës. Kualifikimet për Kupën Evropiane të FIBA 3x3 kanë tërhequr 22% të shikuesve, me një numër prej 1,940 pjesëmarrësish. Ngjarja FIBA 3x3 Women’s Series ka përfaqësuar 19%, me 1,635 shikues. Kampionati Evropian i FIBA për Shtetet e Vogla - Gratë e Rritura ka pasur 11% të totalit të shikuesve, me 919 pjesëmarrës në total, ndërsa Kampionati Evropian U18 i FIBA, Divizioni C për Gratë ka tërhequr 10% të audiencës, me 870 shikues.




Figura 5. Shpërndarja e shikuesve total sipas garës

Pjesëmarrësit më të rinj kanë përbërë shumicën e shikuesve gjatë kampionatit, sipas të dhënave në figurën 6. Grupmosha 18-24 vjeç ka përfaqësuar 24% të totalit të shikuesve, me një mesatare prej 17.78 shikues për ndeshje, duke qenë grupi më i madh dhe më aktiv. Pas tyre, grupmosha 25-34 vjeç ka përbërë 21% të totalit, me një mesatare prej 15.62 shikues për ndeshje. Grupmosha 13-17 vjeç ka përfaqësuar 19% të shikuesve, me një mesatare prej 14.12. Ndërkohë, grupmosha 35-44 vjeç përbën 14% të totalit me një mesatare prej 10.22 shikues për ndeshje. Grupmoshat më të vjetra kanë pasur më pak pjesëmarrës: grupmosha 45-64 vjeç përfaqëson 7% të shikuesve, me një mesatare prej 5.36, ndërsa grupmosha mbi 65 vjeç përfaqëson vetëm 2%, me një mesatare shumë të ulët prej 1.33 shikues për ndeshje. Grupmosha deri në 12 vjeç përbën 12% të shikuesve, me një mesatare prej 8.92. Kjo tregon se grupmoshat e reja, sidomos ato midis 18 dhe 34 vjeç, kanë dominuar shikuesit e kampionatit, ndërsa grupmoshat më të vjetra kanë pasur një prani shumë më të vogël.




Figura 6. Shpërndarja e shikuesve sipas moshës

Impakti social i shikuesve

Përveç të dhënave mbi demografinë e shikuesve të cilat janë regjistruar nëpërmjet formularit të posaçëm, është realizuar gjithashtu edhe një anketë më e detajuar me vetë shikuesit për të vlerësuar më në thellësi impaktin social të tyre. Në total, janë realizuar 265 anketa me shikues. Nga të dhënat demografike të mbledhura, 44% e shikuesve të anketuar për të matur impaktin social janë meshkuj, ndërsa 56% janë femra.

Të dhënat mbi vendin e origjinës së shikuesve të anketuar për matjen e impaktit sportiv tregojnë se një përqindje e lartë e audiencës është nga Kosova, e cila përbën 89% të totalit. Pjesa tjetër e shikuesve përfshin një sërë vendeve me përqindje më të vogla: Shqipëria ka 5.3% të shikuesve të anketuar, ndërsa Malta përbën 1.9%. Përqindja nga vendet si Qipro, Amerika, Armenia, Azerbajxhani, Finlanda, Franca, Italia, dhe Norvegjia është e barabartë, secila me 0.4%.

Nga të dhënat mbi pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), 55% e shikuesve kanë marrë pjesë më parë në aktivitete të organizuara nga FBK-ja, duke treguar një përfshirje të vazhdueshme dhe interes të qëndrueshëm në këto ngjarje. Ndërkohë, 45% e pjesëmarrësve kanë marrë pjesë për herë të parë, gjë që sugjeron se aktivitetet tërheqin gjithashtu një numër të konsiderueshëm të shikuesve të rinj.




Figura 7. A është hera e parë që merrni pjesë në një aktivitet të organizuar nga FBK-ja?

Sipas të dhënave të mbledhura për frekuencën e pjesëmarrjes në aktivitete sportive të organizuara nga FBK, një pjesë e madhe e shikuesve janë të angazhuar rregullisht. 37% e shikuesve të anketuar deklarojnë se marrin pjesë shumë shpesh në këto aktivitete, ndërsa një përqindje pak më e lartë, 38%, thotë se marrin pjesë shpesh. Në krahasim, 21% e shikuesve raportojnë se marrin pjesë rrallë, dhe vetëm 4% tregojnë se marrin pjesë shumë rrallë. Këto të dhëna tregojnë një nivel të lartë angazhimi mes shikuesve, me shumicën që ndjekin aktivitetet e FBK-së në mënyrë të rregullt.




Figura 8. Sa shpesh merrni pjesë në aktivitete sportive të organizuara nga FBK-ja?

Kur analizojmë rezultatet për frekuencën e pjesëmarrjes sipas gjinisë, 78% e femrave dhe 70% e meshkujve raportojnë se marrin pjesë shpesh ose shumë shpesh në aktivitetet sportive të organizuara nga FBK-ja. Nga ana tjetër, 22% e femrave dhe 29% e meshkujve marrin pjesë rrallë ose shumë rrallë. Këto shifra sugjerojnë se, megjithëse shumica e të dy grupeve janë të përfshirë rregullisht, femrat kanë një prirje disi më të lartë për të marrë pjesë më shpesh krahasuar me meshkujt.




Figura 9. Sa shpesh merrni pjesë në aktivitete sportive të organizuara nga FBK-ja? *Sipas gjinisë

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se 66% e pjesëmarrësve në anketë ose anëtarë të grupeve të tyre janë aktivë në sport, duke treguar një prani të fortë të individëve të përfshirë në aktivitete sportive. Ndërkohë, 34% e pjesëmarrësve nuk janë aktivë në sport. Kjo përqindje e lartë e të anketuarve aktivë tregon një audiencë që jo vetëm shikon ngjarjet sportive, por gjithashtu që angazhohet personalisht në aktivitete sportive, duke rritur kështu ndjeshmërinë dhe interesin për ngjarjet e organizuara nga FBK-ja.




Figura 10. A jeni ju apo ndonjëri nga grupi juaj aktiv në sport?

Nga të dhënat e anketës për matjen e impaktit social, rezulton se një ndikim i ndjeshëm është vërejtur tek gjasat për përfshirje të ardhshme në aktivitete sportive. 52% e pjesëmarrësve në këtë anketë kanë deklaruar se ky aktivitet ka rritur motivimin e tyre ose të dikujt nga grupi i tyre për t'u angazhuar në sport në të ardhmen. Kjo tregon se për shumë shikues, pjesëmarrja në ngjarjen e organizuar ka pasur një efekt inkurajues. Në anën tjetër, 48% e të anketuarve nuk kanë ndjerë një ndikim të tillë, duke reflektuar se për një pjesë të audiencës, pjesëmarrja nuk ka ndikuar në planet e tyre për përfshirje në aktivitete sportive në të ardhmen.

Bazuar në të dhënat e mbledhura për planet e pjesëmarrësve për t'u përfshirë në aktivitete sportive, 57% e të anketuarve planifikojnë të përfshihen në basketboll, duke e bërë këtë sportin më të preferuar. Pas tij, disa pjesëmarrës kanë përmendur kombinime të sporteve si basketboll dhe futboll apo fitnes dhe vrapim, por këto grupe përbëjnë përqindje më të vogla (rreth 0.7% - 1.4% secili). Futbollit është zgjedhja e 3.6% të të anketuarve, ndërsa noti dhe volejboli përfaqësohen nga 2.2% secili. Gjithashtu, një pjesë e vogël e të anketuarve nuk kanë vendosur ende se në çfarë sporti do të përfshihen, me 1.4% që raportojnë këtë. Interesante është edhe fakti që 5.1% planifikojnë të jenë thjesht shikues. Një përqindje më e ulët raportoi aktivitete të tjera si ecja, kamping ose kikkoks, të gjitha me përqindje të vogla, nën 1%.




Figura 11. A ka rritur ky aktivitet gjasat që ju apo dikush nga grupi juaj të përfshihen në aktivitete sportive në të ardhmen?

Rezultatet e anketës me shikues tregojnë se aktiviteti ka ndikuar më shumë tek femrat për të rritur gjasat që ato ose dikush nga grupi i tyre të përfshihen në aktivitete sportive në të ardhmen, me 56% të tyre që u përgjigjën pozitivisht. Ndërkohë, 47% e meshkujve raportuan të njëjtën gjë. Anasjelltas, një pjesë më e madhe e meshkujve, 53%, menduan se aktiviteti nuk kishte rritur gjasat për përfshirje të ardhshme në sport, krahasuar me 44% të femrave.




Figura 12. A ka rritur ky aktivitet gjasat që ju apo dikush nga grupi juaj të përfshiheni në aktivitete sportive në të ardhmen?
*Sipas gjinisë

Sipas rezultateve të anketës me shikuesit, organizimi i aktivitetit është vlerësuar pozitivisht nga pjesëmarrësit, me 98% që e klasifikojnë atë si pozitiv ose shumë pozitiv. Vetëm 2% e të anketuarve e kanë përshkruar organizimin si negativ. Këto shifra tregojnë se aktiviteti ka arritur të krijojë një ndikim të favorshëm dhe tërheqës për shumicën e pjesëmarrësve, duke reflektuar një sukses të dukshëm në organizimin e tij.




Figura 13. Si do ta vlerësonit organizimin e këtij aktiviteti në tërësi?

Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të anketuar ndihen krenarë për organizimin e aktivitetit nga qyteti ose shteti i tyre, me 54% që shprehen se janë shumë krenar dhe 32% që janë krenar. Vetëm 2% raportojnë se nuk ndihen krenarë, dhe nuk pati asnjë që të shprehej se nuk ndihet aspak krenar. Gjithashtu, 11% e të anketuarve deklaruan se nuk janë nga Kosova, ndërsa 1% nuk janë të sigurt për përgjigjen e tyre. Rezultatet sugjerojnë një ndjenjë të fortë të krenarisë dhe përkatësisë midis pjesëmarrësve vendas, duke reflektuar një mbështetje të gjerë për organizimin e ngjarjes.




Figura 14. A ndiheni krenar për qytetin/shtetin tuaj që organizoi këtë aktivitet?

Rezultatet e anketës me shikues tregojnë se femrat janë më të prirura të shprehin ndjenjën e krenarisë për qytetin apo shtetin që organizoi këtë aktivitet, me 59% që deklaruan se ndihen shumë krenare krahasuar me 47% të meshkujve. Për më tepër, 30% e femrave dhe 34% e meshkujve u shprehën krenarë. Nga ana tjetër, një përqindje e vogël e të dyja gjinive ndihen jo krenarë ose aspak krenarë. Sa i përket të anketuarve që nuk janë nga Kosova, 14% e meshkujve dhe 9% e femrave raportuan se nuk janë të Kosovës.




Figura 15. A ndiheni krenar për qytetin/shtetin tuaj që organizoi këtë aktivitet? *Sipas gjinisë

Sipas rezultateve, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve (88%) besojnë se organizimi i këtij aktiviteti përfaqëson një arritje për shtetin e Kosovës, duke theksuar vlerësimin e lartë për këtë ngjarje si një sukses kombëtar. Vetëm 4% nuk e konsiderojnë atë si një arritje, ndërsa 8% nuk janë të sigurt.




Figura 16. A mendoni se organizimi i këtij aktiviteti është një arritje për shtetin e Kosovës?

Bazuar në të dhënat, 57% e pjesëmarrësve mendojnë se organizimi i këtij aktiviteti ka përmirësuar ndjeshëm perceptimin e Kosovës nga të tjerët, ndërsa 32% besojnë se ka pasur një përmirësim të moderuar. Vetëm 11% e të anketuarve nuk kanë vërejtur ndonjë ndryshim në perceptim.




Figura 17. Si mendoni se ky aktivitet ndikon në perceptimin e Kosovës nga të tjerët?

Të dhënat tregojnë se 33% e pjesëmarrësve kanë vërejtur përfitime për komunitetin lokal të Prishtinës si rezultat i aktivitetit, ndërsa 51% nuk kanë vërejtur përfitime të tilla. Një pjesë tjetër, 11%, nuk janë nga Kosova dhe 5% nuk janë të sigurt. Këto shifra sugjerojnë se përfitimet e drejtpërdrejta për komunitetin lokal nuk janë ndjerë në mënyrë të barabartë, duke reflektuar ndoshta një perceptim të kufizuar të ndikimit pozitiv të aktivitetit në jetën e përditshme të qytetarëve të Prishtinës.




Figura 18. A keni vërejtur ndonjë përfitim të komunitetit lokal të Prishtinës nga ky aktivitet?

Për më tepër, rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e pjesëmarrësve kanë përjetuar emocione pozitive gjatë pjesëmarrjes në aktivitet, me 66% që raportojnë se janë ndjerë shumë mirë dhe 32% që janë ndjerë mirë. Vetëm 2% kanë pasur ndjenja neutrale, duke u ndjerë asnjëherë gjatë aktivitetit. Këto të dhëna sugjerojnë se atmosfera dhe organizimi i ngjarjes kanë arritur të krijojnë një përvojë pozitive për pjesëmarrësit, duke nxitur një nivel të lartë kënaqësie mes tyre.




Figura 19. Si ndiheni gjatë pjesëmarrjes në këtë aktivitet?

Së fundmi, 48% e pjesëmarrësve në anketë kanë vërejtur një ndryshim pozitiv në disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në aktivitet, ndërsa 52% nuk kanë vërejtur asnjë ndryshim.

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit që raportuan një ndryshim në disponim e përshkruan atë si pozitiv, me 99% që shprehën përmirësim në ndjesitë e tyre gjatë aktivitetit. Vetëm 1% nuk ishin të sigurt për natyrën e këtij ndryshimi.




Figura 20. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në disponimin tuaj gjatë pjesëmarrjes në këtë aktivitet?

Në lidhje me sugjerimet dhe komentet e pjesëmarrësve për aktivitetin, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kishin asnjë koment shtesë për të ndarë. Nga ata që ofruan sugjerime, shumica kërkuan përmirësime në kushtet e ambientit, si shtimi i çadrave, ujit, dhe karrigeve. Ndërkohë, një pjesë rekomandoi organizimin e më shumë aktiviteteve të ngjashme në të ardhmen, dhe një përqindje më e vogël sugjeroi më shumë marketing për të promovuar aktivitetin.

Impakti ekonomik

Impakti ekonomik i garave të verës ka përfshirë si impaktin direkt, ashtu edhe atë indirekt. Për vlerësimin e impaktit ekonomik indirekt, janë analizuar shpenzimet e ekipeve pjesëmarrëse për akomodim, ushqim, udhëtim dhe mallra, të cilat u mbledhën përmes intervistave me përfaqësuesit e ekipeve. Objektivi ishte intervistimi i një përfaqësuesi nga çdo ekip pjesëmarrës në gara, duke realizuar gjithsej 41 intervista. Në anën tjetër, për llogaritjen e impaktit ekonomik direkt, janë përdorur shpenzimet totale të organizimit të garave sportive të verës nga Federata e Basketbollit të Kosovës.

Impakti ekonomik direkt

Për të llogaritur impaktin ekonomik direkt, janë përdorur të dhënat e shpenzimeve totale për organizimin e ngjarjeve sportive të verës nga Federata e Basketbollit të Kosovës. Gjatë periudhës së organizimit, janë përfshirë gjithsej 124 persona, përfshirë stafin dhe vullnetarët, duke rezultuar në një kosto totale prej 26,035 euro. Ngjarjet sportive përfshijnë FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier, FIBA Small Countries, FIBA 3x3 Challenger, FIBA 3x3 Women's Series, dhe FIBA U18 Women's EuroBasket. Çdo ngjarje ka pasur kërkesa të ndryshme për burime njerëzore dhe financiare, me FIBA Small Countries që ka pasur numrin më të madh të stafit dhe vullnetarëve, si dhe shpenzimet më të larta. Përveç kësaj, janë regjistruar shpenzime shtesë për organizimin e secilës prej garave të listuara më sipër.

- Konkretisht, shpenzimet për organizimin e FIBA 3X3 FIBA Europe Cup Qualifier që përfshijnë kujdesin mjekësor, akomodimin, transportin, sigurimin fizik, xhirimin, marketingun, dhe aspekte të tjera logjistike e promociionale, arrijnë në një total prej **40,547.31 euro**.

- Shpenzimet për organizimin e FIBA Women's European Championship for Small Countries, që përfshijnë akomodimin, transportin, kujdesin mjekësor, sigurimin fizik, tarifat e arbitrimin, ushqimin, materialet promocionale dhe logjistikën, arrijnë në një total prej **117,761.41 euro**.
- Shpenzimet për organizimin e FIBA U18 Women's EuroBasket 2024, që përfshijnë akomodimin, transportin, ushqimin, kujdesin mjekësor, tarifat e arbitrimin, brendimin, ceremoninë dhe logjistikën, arrijnë në një total prej **73,140.08 euro**.
- Shpenzimet për organizimin e FIBA 3x3 Challenger & FIBA Women's Series 2024 për përkujdesje mjekësore, akomodim dhe veshje sportive, cilat kanë arritur në **11,646 euro**.

Në total, shpenzimet totale direkte, apo kontributi direkt në ekonominë e Kosovës të llogaritura për organizimin e garave sportive të verës nga FBK është **269,129.80 euro**.

Impakti ekonomik indirekt

Impakti ekonomik indirekt i ngjarjeve të FIBA 3x3 dhe FIBA Women's Series 2024 është analizuar përmes shpenzimeve të ekipit, të cilat arritën një total prej **150,741.26 euro**. Kjo përfshin shpenzimet e pjesëmarrësve të ekipeve për ushqim, pije, mallra/veshmbathje, suvenire, transport dhe argëtim. Pjesëmarrësit në këto gara kanë shpenzuar mesatarisht 158.75 euro për ushqim, 92.60 euro për pije, 390.00 euro për mallra/veshmbathje, 65.29 euro për suvenire, 172.43 euro për transport dhe 119.15 euro për argëtim. Siç vërehet në tabelën 3 më poshtë, shpenzimi më i madh është bërë për mallra dhe veshmbathje, me një total prej 55,770 euro, ndërsa shpenzimi për transport ka arritur në 30,175 euro. duke pasqyruar një ndikim të konsiderueshëm në ekonominë lokale.

Tabela 3. Përmbledhje e impaktit ekonomik indirekt

Lloji i shpenzimit	Shpenzimi mesatar	Proxy i pjesëmarrësve në ekip që kanë shpenzuar ¹	Shpenzimet totale ekipore
për ushqim	€ 158.75	155	€ 24,606.25
për pije	€ 92.60	197	€ 18,242.20
për mallra/veshmbathje	€ 390.00	143	€ 55,770.00
për suvenire	€ 65.29	150	€ 9,794.12
për transport	€ 172.43	175	€ 30,175.00
për argëtim	€ 119.15	102	€ 12,153.69
			€ 150,741.26

Të gjeturat kryesore mbi impaktin ekonomik:

- a) Shpenzimet totale direkte të llogaritura për organizimin e ngjarjeve sportive të verës nga FBK janë 269,129.80 euro.
- b) Shpenzimet totale indirekt, apo kontributi indirekt në ekonominë e Kosovës, të llogaritura përmes shpenzimeve të ekipeve, arritën një total prej 150,741.26 euro.
- c) Shpenzimi mesatar për ushqim nga pjesëmarrësit e ekipeve në turne ishte 158.75 euro.

¹ Proxy është llogaritur bazuar në anketën e realizuar me përfaqësues të ekipeve mbi shpenzimet mesatare gjatë qëndrimit në Kosovë.

- d) Shpenzimi mesatar për pije nga pjesëmarrësit e ekipeve ishte 92.60 euro.
- e) Shpenzimi për mallra dhe veshmbathje ishte mesatarisht 390.00 euro.
- f) Shpenzimi për suvenire ishte mesatarisht 65.29 euro.
- g) Shpenzimi për transport ishte mesatarisht 172.43 euro.
- h) Shpenzimi mesatar për argëtim ishte 119.15 euro.

Kontributi total në ekonominë e Kosovës nga organizimi i garave sportive verore nga Federata e Basketbollit të Kosovës përfshin: 269,129.80 euro si kontribut direkt përmes shpenzimeve të organizimit dhe 150,741.26 euro si kontribut indirekt përmes shpenzimeve të ekipeve, duke arritur një total prej **419,871.06 euro**.

Impakti Sportiv

Për të matur impaktin sportiv, u realizuan anketa me pjesëmarrësit në gara, trajnerët dhe zyrtarët për të mbledhur të dhëna mbi përvojat dhe perceptimet e tyre lidhur me ndikimin sportiv të aktiviteteve, përfshirë cilësinë e garave, cilësinë e infrastrukturës (objekteve/sallave) dhe organizimin e përgjithshëm. Për vlerësimin e këtij impakti, u synua intervistimi i një përfaqësuesi nga të gjitha ekipet pjesëmarrëse në pesë aktivitetet, duke bërë të mundur realizimin e 44 anketa në total me përfaqësues të 35 ekipeve.

Rolet e përgjegjësve në këto ekipe që kanë plotësuar anketën 41% janë lojtarë, 30% trajnerë, 20% zyrtarë, dhe 9% kanë disa pozita të tjera si fizioterapistë, kreu i delegacionit, dhe staf mjekësor.

Kur përfaqësuesit e ekipeve pjesëmarrës në garë u pyetën për cilësinë e përgjithshme të garave në aktivitet, shumica e vlerësuan atë si të lartë (24 përgjigje ose 55%), ndërsa një pjesë e konsiderueshme e cilësuan si shumë të lartë (8 përgjigje ose 18%). Së bashku, 73% e përfaqësuesve e vlerësuan cilësinë si të lartë ose shumë të lartë. Një pjesë tjetër (9 përgjigje ose 20%) e konsideruan cilësinë si mesatare, ndërsa vetëm 3 përfaqësues (7%) raportuan se ishte e ulët. Këto rezultate sugjerojnë që, në përgjithësi, garat u perceptuan pozitivisht nga pjesëmarrësit, por gjithsesi kishte hapësirë për përmirësim.




Figura 21. Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të garave në këtë aktivitet?

Kur u pyetën për cilësinë e objekteve dhe sallave ku u zhvilluan aktivitetet, shumica e përfaqësuesve e vlerësuan atë si mesatare (24 përgjigje ose 55%), duke treguar se ndonëse kishte disa vlerësime pozitive, ekziston ende hapësirë për përmirësim në infrastrukturën e përdorur gjatë aktivitetit. Një pjesë më e vogël e përfaqësuesve e konsideruan cilësinë si të lartë (10 përgjigje ose 23%) dhe 6 prej tyre (14%) e vlerësuan si shumë të lartë. Nga ana tjetër, 4 përfaqësues (9%) raportuan se cilësia ishte e ulët.




Figura 22. Si e vlerësoni cilësinë e objekteve/sallave ku u zhvilluan aktivitetet?

Në lidhje me disponueshmërinë e pajisjeve dhe infrastrukturës për të përmbushur nevojat e ekipeve pjesëmarrëse, shumica e përfaqësuesve (34 ose 77%) u përgjigjën pozitivisht, duke treguar se pajisjet dhe infrastruktura ishin të mjaftueshme. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme (10 ose 23%) raportuan se pajisjet dhe infrastruktura nuk ishin të mjaftueshme për nevojat e tyre, duke sugjeruar mundësi për përmirësim në këtë aspekt.

Për përmirësimin e infrastrukturës, përfaqësuesit e ekipeve sugjeruan disa ndryshime të rëndësishme. Ata theksuan nevojën për një fushë stërvitjeje më cilësore dhe një hapësirë më të përshtatshme për lojtarët, përfshirë furnizimin me ujë të mjaftueshëm dhe përmirësimin e dhomave të lojtarëve. Gjithashtu, u kërkua një fushë zyrtare për ngrohje në vendngjarje dhe një tribunë të përshtatshme për lojtarët që të mund të ndjekin rezultatit dhe ndalesat e lojës. Ndër sugjerimet e tjera ishin shtimi i pajisjeve si peshqirë, ushqime, fruta, dhe përmirësimi i zonës ku qëndrojnë ekipet jashtë lojës për të ofruar më shumë hapësirë dhe komoditet. Përfaqësuesit vunë theksin edhe në përmirësimin e kushteve për të përballuar nxehtësinë kur ndeshjet zhvillohen në stinën e verës dhe për një vendndodhje më të përshtatshme për aktivitetin.



Figura 23. A ka pasur pajisje dhe infrastrukturë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat tuaja?

Pjesëmarrësit në aktivitet e vlerësuan organizimin e përgjithshëm si më poshtë: 27% e tyre e cilësuan si shumë të lartë, ndërsa 36% e vlerësuan si të lartë. Së bashku, këto dy kategori përfaqësojnë 63% të pjesëmarrësve që raportuan një nivel të lartë kënaqësie me organizimin. Një përqindje e konsiderueshme, 30%, e cilësoi organizimin mesatar, dhe 7% e vlerësuan si të ulët. Këto rezultate pasqyrojnë një nivel të përgjithshëm pozitiv të vlerësimit, me shumicën që raportojnë një përvojë të mirë ose shumë të mirë.




Figura 24. Si e vlerësoni organizimin e përgjithshëm të aktivitetit?

Shumica e përfaqësuesve të ekipeve, 40 persona (91%), raportuan se aktivitetet ishin të organizuara mirë dhe të planifikuara në mënyrë efektive, ndërsa vetëm 4 persona (9%) nuk ishin të njëjtit mendim siç tregohet në figurën 25. Këto rezultate tregojnë një vlerësim të lartë të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve nga pjesëmarrësit në anketë.

Përfaqësuesit e ekipeve shprehën disa preferenca pozitive në lidhje me organizimin e aktivitetit. Barazia e trajtimit midis çdo ekipi ishte një pikë e rëndësishme për disa, duke treguar angazhimin për një mjedis konkurrues të drejtë. Ekipi i zërimit dhe organizimi i garave gjithashtu u vlerësuan mirë, si dhe mikpritja dhe ndihma që morën gjatë aktivitetit. Lokacioni dhe salla e lojës ishin gjithashtu të pëlqyera, ndërsa komunikimi i mirë dhe orari funksional u vlerësuan si faktorë të rëndësishëm për suksesin e organizimit. Vëmendja ndaj nevojave të ekipeve dhe mbështetja nga stafi dhe udhëzuesit e ekipit kontribuan gjithashtu në një përvojë pozitive për të gjithë pjesëmarrësit.

Përfaqësuesit e ekipeve sugjeruan disa aspekte që mund të përmirësohen në lidhje me organizimin e aktiviteteve. Një nga rekomandimet kryesore ishte ofrimi i më shumë kohës për stërvitje, e cila do të ndihmonte ekipet të përgatiteshin më mirë për garat. Po ashtu, u theksua nevoja për një palestër rezervë që do të mund të përdorej në rast të kushteve atmosferike që nuk lejojnë zhvillimin e lojërave në ambient të hapur. Përveç kësaj, ata sugjeruan përmirësimin e transportit, duke kërkuar që ai të jetë falas dhe të mbulohet nga Komiteti Organizativ (LOC), për të lehtësuar lëvizjen e ekipeve dhe për të siguruar një përvojë më të mirë gjatë aktiviteteve.




Figura 25. A ishin aktivitetet e organizuara mirë dhe të planifikuara në mënyrë efektive?

Siç paraqitet në figurën 29, aktiviteti ka kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive të ekipit për një pjesë të konsiderueshme të pjesëmarrësve, pasi 59% e të anketuarve raportuan se kishin vërejtur përmirësime në performancën e ekipit si rezultat i pjesëmarrjes në këtë aktivitet, ndërsa 41% e tyre shprehen se nuk kishin vërejtur ndonjë ndryshim.

Pjesëmarrësit në aktivitet theksuan disa përmirësime të rëndësishme që kishin vërejtur në ekipet e tyre si rezultat i angazhimit në këtë aktivitet. Ata përmendën rritjen e bashkëpunimit dhe kohezionit brenda ekipit, si dhe avancimin në kualifikimin për Kupën Evropiane. Një tjetër aspekt i rëndësishëm ishte angazhimi i lojtarëve të rinj, i cili kontribuoi në freskimin dhe forcimin e skuadrës.

Pjesëmarrësit gjithashtu vlerësuan organizimin e mirë dhe profesionalizmin e ekipit organizues, duke theksuar se këto aspekte kishin ndihmuar në rritjen e cilësisë së lojës. Në përgjithësi, zhvillimi i lojtarëve dhe përvoja e fituar gjatë aktivitetit ishin elemente thelbësore për përmirësimin e performancës së ekipeve.




Figura 26. A keni vërejtur përmirësime në performancën e ekipit tuaj si rezultat i pjesëmarrjes në këtë aktivitet?

Së fundmi, pjesëmarrësit në aktivitet shprehën disa sugjerime dhe komente për të përmirësuar përvojën e tyre. Një nga shqetësimet e përmendura ishte çatia, e cila krijonte probleme për atletët. Ata sugjeruan që të ofroheshin mundësi alternative për lavanderinë, pasi shërbimi në hotel ishte shumë i shtrenjtë. Po ashtu, ata shprehën shqetësim për praninë e një diskoje në çatinë e hotelit, e cila luante muzikë deri vonë, duke penguar kështu qetësinë e atleteve.

Disa pjesëmarrës theksuan nevojën për një seriozitet më të lartë ndaj formatit të garës, duke sugjeruar stërvitje dhe lojëra miqësore ose konkurruese më të shpeshta për arritjen e rezultateve më të mira. Ata gjithashtu kërkuan përmirësimin e cilësisë së shiritave në dysheme, në mënyrë që të mos shkëputeshin ose ngjiteshin në këpucët e lojtarëve. Një tjetër sugjerim ishte sigurimi i letrës higjienike në të gjitha tualetet, për të siguruar kushte më të mira higjienike për të gjithë pjesëmarrësit.

Përfundime

Ngjarjet e FIBA në Prishtinë kanë pasur një ndikim të dukshëm në përfshirjen e komunitetit dhe kanë rritur angazhimin e individëve dhe grupeve të ndryshme sociale. Të intervistuarit në lidhje me impaktin organizativ theksuan përmirësimet e vazhdueshme, veçanërisht në menaxhimin e stafit dhe trajnimin e vullnetarëve, të cilët shpesh janë basketbollistë. Ky zhvillim ka kontribuar në rritjen e aftësive organizative dhe ka ndihmuar në menaxhimin më mirë të eventeve, duke u bërë më efektiv vit pas viti. Stafi i trajnuar dhe eksperiencia e akumuluar ka mundësuar që çdo aktivitet të realizohet me sukses,

përkundër disa sfidave me infrastrukturën. Ky përmirësim ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e organizatës nga ana e publikut, duke rritur interesin dhe mbështetje nga sponsorët, si dhe ka ndihmuar në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me autoritetet shtetërore dhe institucionet e tjera.

Në aspektin social, të dhënat mbi audiencën dhe impaktin e aktiviteteve janë gjithashtu të rëndësishme. Pjesëmarrësit më të rinj, në veçanti ata midis moshave 18-34 vjeç, kanë dominuar në shikueshmëri, duke dëshmuar se aktivitetet e organizuara janë tërheqëse për audiencat e rinj. Po ashtu, shpërndarja e shikuesve sipas ngjarjeve sportive ka treguar se formatet si FIBA 3x3 Challenger kanë tërhequr më shumë interes. Këto të dhëna sugjerojnë se organizimi i aktiviteteve sportive dhe mbështetja e sponsorizimeve dhe autoriteteve shtetërore janë faktorë kyç në zhvillimin e mëtejshëm të FBK-së dhe në rritjen e ndjeshme të impaktit të saj në shoqëri.

Në bazë të analizës së impaktit ekonomik dhe sportiv, mund të konkludohet se ngjarjet e organizuara kanë pasur një ndikim të dukshëm në ekonominë lokale dhe kanë ofruar mundësi për përmirësime në infrastrukturën dhe organizimin sportiv. Shpenzimet totale direkte për organizimin e ngjarjeve nga Federata e Basketbollit të Kosovës ishin 269,129.80 euro, ndërsa shpenzimet indirekte, të cilat përfshinin shpenzimet e ekipeve për ushqim, pije, mallra, transport dhe argëtim, arritën 150,741.26 euro, duke kontribuar në një total prej 419,871.06 euro për ekonominë e Kosovës. Kjo tregon se ngjarjet sportive kanë një ndikim të rëndësishëm ekonomik, sidomos në sektorët e turizmit dhe shërbimeve lokale.

Nga ana sportive, pjesëmarrësit në gara vlerësuan cilësinë e përgjithshme të ngjarjeve si të lartë dhe shumë të lartë, dhe ky nivel i kënaqësisë ishte i dukshëm gjithashtu përsa i përket organizimit të përgjithshëm të aktiviteteve. Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësime, veçanërisht në infrastrukturën e përdorur, ku u identifikuan disa nevoja për përmirësime, siç janë fushat më cilësore stërvitjeje dhe kushte më të mira për lojtarët. Gjithashtu, disa sugjerime përfshinin përmirësimin e kushteve për përballimin e nxehtësisë gjatë periudhës së verës dhe ofrimin e një vendndodhjeje më të përshtatshme për aktivitetet. Pavarësisht disa kërkesave për përmirësim, shumica e pjesëmarrësve raportuan një përvojë pozitive dhe organizim të mirë të aktiviteteve.